



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
 Dama

31-07-2018

P. nr. 1100/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga Gjyqtari individual, Adem Shabani, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtoren Profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit, [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 285 par 2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1946-2/16 të dt.15.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt.10.04.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit të shtetit të pandehurit, dhe të dëmtuarit, dhe me datën 12.04.2018, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur me datë [REDACTED], në të njëjtin vend nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, pensionist, ka të kryer fakultetin, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në lirime numër personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTORË

Sepse me dt. 06.10.2016, në kohë të pacaktuar, në pyllin privat, në vendin e quajtur "Mbi rrug", në parcelën me numër 1040 të evidentuar në fletën poseduese me numër 99 në Zonën Kadastrale Mirash, Komuna Ferizaj, prone e të dëmtuarit, [REDACTED] ka prerë dru të njoma të llojit të bungut në sasi prej 200 metra kub sipas të dëmtuarit,-

Me të cilën kreu veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 365 të KPPK-së

GJYKON

Të pandehurit [REDACTED], i shqipton dënim me kusht dhe atë: dënimin me gjobë në shumë 200 /dyqind / Euro dhe dënim me burg prej 4 (katër) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Të dëmtuarin [REDACTED], nga Ferizaj, rruga [REDACTED] [REDACTED] kati [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i pandehuri të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr.1946-2/16 të dt.15.11.2016, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga fsh [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, i akuzuar për veprën penale penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2. të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve gjyqësore të zhvilluara e posaçërisht pas dëgjimit të dëmtuarit [REDAKTUAR] leximit të provës materiale fletës poseduese me nr.99 e dt.18.05.2008, e lëshuar nga Drejtoria për Kadaster Gjeodiezi dhe Pronësi ne Ferizaj, ngastra me nr.1040, me kulture Mal, me sip.prej 10,27 ari, Zona Kadastrale Mirash K.Ferizaj dhe fotove nga vendi i ngjarjes edhe nga mbrojtja e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri e ka kryer veprën penale qe e ngarkon aktakuza, i ka propozuar qe te njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim te parapare me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 27.03.2017, konform nenit 246 të KPPK-së të pandehurin e ka udhëzuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, dhe atij i ka dhënë mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, dhe përkitazi me këtë i pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Meqë i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka udhëzuar atë se para shqyrtimit të dytë, mund të paraqes kundërshtim kundër provave si dhe kërkesa për hudhjen e aktakuzës, konform nenit 245 par 6 dhe neneve 249 dhe 250 KPPK-së.

I pandehuri [REDAKTUAR] para shqyrtimit të dytë me datën 25.04.2017, në gjykatë ka sjellë kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kundër tij.

Gjykata me dt.05.07.2017, ka mbajtur shqyrtimin e dytë gjyqësor, ku prokurorit të shtetit, dhe të dëmtuarit i ka dorëzuar nga një ekzemplarë të kërkesës për hedhjen e aktakuzës.dhe ka mbajtur shqyrtimin e dytë ku gjykata e ka parë të arsyeshme që të mbaj seancën dëgjimore që të merr mendimin e palëve lidhur me provat-kërkesën e të pandehurit që ka kërkuar që të hudhët aktakuza.

Në shqyrtimin e dytë i pandehuri [REDAKTUAR] deklaruar se mbetem pranë kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe në vazhdim ka theksuar se për veprën penale që akuzohem nuk është i

fajshëm e për këtë kësaj kërkesë i ka bashkangjitur provat dhe ato: fletën poseduese e dt.02.10.1978, ku kjo patundshmëri evidentohet në emër të vëllait [REDAKTUAR] dhe nuk ka tjera prova që dëshmojnë se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës të ushtruar nga i pandehuri [REDAKTUAR] sipas vlerësimit të gjyqtarit gjykues në këtë fazë të procedurës kërkesa e parashtruar nuk është aprovuar sepse në shkresat e lëndës rezultojnë dyshim i bazuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, bazuar në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe ato: Deklarata e të pandehurit e datës 07.10.2016 dhe 18.10.2016, deklarata e të dëmtuarit e datës 07.10.2016 dhe 11.10.2016, fleta poseduese me numër 99 në Zonën Kadastrale Mirash, Komuna Ferizaj të datës 18.05.2008, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës. andaj nuk i aprovoj si të bazuar në këtë fazë të procedurës penale.

Gjykata me aktvendim mbi hüdhen e kërkesës në këtë fazë mendon se ofrohet mundësia për shqyrtim të gjithanshëm gjyqësor në këtë çështje penale, përmes të cilit do të ipet mundësia e shqyrtimit të provave të propozuara nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe provave që janë propozuar nga mbrojtësit të të akuzuarit duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar asnjë prove dhe pa prejudikuar epilogun përfundimtar të këtij gjykimi.

Gjykata sipas radhës në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin kryesor me dt.16.11.2017, dhe ka ftuar të pandehurin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të njejtin në kuptim të nenit 323 paragraf.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit edhe në shqyrtimin kryesor të pandehurit i ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe i ka ofruar mundësi të deklarojë mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohet.

I pandehuri [REDAKTUAR] nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pasi i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1. të KPPK-së.

Konform nenit 329 të KPPK-së gjykata ka bërë prezantimin e provave që i ka konsideruar të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

Në seancat gjyqësore i dëmtuari [REDAKTUAR] në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se parcela e cila është objekt shqyrtimi është pronë e cila evidentohet në emër të nanës së tij Feride

███ të cilën e ka trashëguar nga babi i tij ███ dhe po në këtë ngaster, vendi i quajtur mal evidentohet në fshatin Mirash ngastra nr.1040, vendi i quajtur mbi rrugë me kulture Mal, ku i pandehuri qe tri vite ka shkaktuar dëm në këtë parcele, ku për këtë ka njoftuar policin dhe ka dhënë deklaratë, dhe i ka njoftuar zyrtaret policor se dëmi është shkaktuar nga migja i tij tani i pandehuri ███ Në vazhdim ka deklaruar se në vendin ku është shaktuar dëmi preja e drunjëve nuk e ka takuar të pandehurin por ka dyshuar në mixhën e tij dhe ka shkuar te shtëpia e tij ku në oborrin e tij ka par traktorin e ngarkuar me drunjë, disa në tokë të llojit bung dhe qarr ku dëmi i përgjithshëm është.250 m3,dhe të gjitha këto drunjë i ka bartur me traktorin e tij, dhe i bashkangjitet ndjkejes penale dhe parashton kërkesë pasurore-juridike per dënimin qe i ka shkaktuar ne vlere prej 8000 Euro, qe t'ia kompenzoj.

Në gjykatë me propozimin e të akuzuarit ishte ftuar në cilësinë e dëshmitarit ███ nga fshati ███ Komuna Ferizaj, tani me vendbanim në Ferizaj ku i njëjti është paraqitur ne Gjykate dhe nga Gjykata është njoftuar arsytet se për çfarë është ftuar dhe nga kush është propozuar.

Gjykata konform nenit 333 par. 1 të KPPRK-së e njofton te pandehurin ███ se ju e keni propozuar dhe ju do e merrni ne pyetje dëshmitarin, por i heq vërejtjen të pandehurit që ti parashton pyetje dëshmitarit me rregullat e procedurës së provave, por dëshmitari nuk ka dijeni lidhur me me këtë rast dhe nuk di se çka të dëshmoj gjykata heqë dorë që të ndëgjohet në cilësinë e dëshmitarit.

Gjykata në fazën e administrimit të provave ne vazhdim të shqyrtimin gjyqësor ka lexuar Fletës Poseduese me numër 99 në Zonën Kadastrale Mirash, Komuna Ferizaj të datës 18.05.2008, shiqimit të fotografive që gjinden në shkresat e kësaj lende penale.

I pandehuri ███ në seancat gjyqësore ka deklaruar se nuk e ndien veten të fajshëm pasi për veprën penale që akuzohet se i ka shkaktuar dëm në ngastrën me nr.1040, me kulture Mal, me sip.prej 10,27 ari, Zona Kadastrale Mirash K.Ferizaj, të ███ pasi me asnjë provë nuk mundë të dhëshmoj ███ se posedon mal dhe aty që më akuzon se i kam shkaktuar dëm nuk qëndron. Në vazhdim në mbrojtjen e tij ka deklaruar se se me të dëmtuarin ███ jemi të afërm e ka djalë të vllaut dhe kur janë ndarë me vllaun më të vjetër ███ pasuria për të cilën po akuzohem është blerë më vonë prej banoreve te tjere të fshatit dhe drujtë për të cilat akuzohet deklaroi se i ka prerë në pronën e tij dhe se i ka bartur nga aty me traktor dhe i ka sjellë në oborrin e shtëpisë se tij, ku edhe tani ka drunje te grumbulluar aty dhe jo vetëm nga ky vite por edhe ne vitet e mëparme, por nuk di për nga masa drurore se sa janë por e di se mbrenda një vitë shpenzojnë diku rreth 15 metra e për këtë nuk e ndien veten fajtor dhe ika propozuar gjykatës që ta liron nga përgjegjësia penale.

Gjykata pas zbatimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe të gjitha në tërësinë e tyre konform nenit 7,8 dhe 361 paragrafi 1 dhe 2 KPPPK-së vërtetoi këtë gjendje faktike: se me dt. 06.10.2016, në kohë të pacaktuar, në pyllin privat, në vendin e quajtur " Mbi rrug ", në parcelen me numër 1040, të evidentuar në fletën poseduese me

numër 99 në Zonën Kadastrale Mirash, Komuna Ferizaj, prone e të dëmtuarit, [REDACTED] ka prerë dru të njoma të llojit të bungut në sasi prej 200 metra kub sipas të dëmtuarit,-

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë, dëgjimit të të dëmtuarit [REDACTED] leximin e Fletës Poseduese me numër 99 në ngastrën me nr.1040, me kulture Mal, me sip.prej 10,27 ari, Zona Kadastrale Mirash K.Ferizaj të dates 18.05.2008, shiqimit të fotografive që gjenden në shkresat e kësaj lende penale.

Gjykata dëshmisë së të dëmtuarit [REDACTED] dhënë në shqyrtimin gjyqësor i shprehu besimin pasi që e njëjta ishte logjike, e konkretizuar përkritazi me përshkrimin e veprimeve inkriminuese të të pandehurit si dhe njëkohësisht është në harmoni edhe me prova tjera që gjenden në shkresat e kësaj lende penale, por lidhur me dëmin që i'u është shkaktuar të dëmtuarit nuk e aprovoj pasi vlerësimi dhe llogaritja e dëmit nuk është vlerësuar nga ekspertët e lëmijës përkatëse andaj për realizimin e kërkesës se tij pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Gjendjen e përshkruar faktike më lartë gjykata e vërtetoi në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit [REDACTED] pjesërisht nga mbrojtja e të pandehurit dhe nga fleta poseduese me numër 99 në Zonën Kadastrale Mirash, Komuna Ferizaj të datës 18.05.2008, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës .

Mbrojtjen e të akuzuarit se nuk i ka prerë drunjte në parcelën që akuzohet gjykata e vlerëson si të pa bazuar dhe të orientuar në drejtim të justifikimit të veprimeve inkriminuese, pasi që një mbrojtje e tillë është jo bindëse pasi gjykatës nuk i ka ofruar asnjë prove në asnjë fazë të procedurës dhe është në kundërshtim me provat tjera të zbatuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori sjelljet e tij korrekte në shqyrtimin gjyqësor, moshën e tij të vjetër, në pension dh mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoj dënim, si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin [REDACTED] nga Ferizaj Rr." [REDACTED], per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1100/16 e dt.03.04.2018

Bashk.Profesional:
Mimoza Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.